



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 6479 Prot.

Tiranë, më 7.10.2022

UDHËZIM

NR. 29 DATË 7.10.2022

**PËR  
FREKUENTIMIN E PROCESIT MËSIMOR, SIPAS LLOJIT TË VEPRIMTARIVE  
MËSIMORE NË AUDITOR DHE CIKLIT TË STUDIMIT**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3 të nenit 87, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimit nr. 824, datë 24.12.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së arsimit të lartë”, Ministri i Arsimit dhe Sportit,

**UDHËZOJ:**

1. Përcaktimi i frekuentimit të procesit mësimor sipas llojit të veprimtarive mësimore në programet e studimit me karakter profesional, programet e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë të studimit.
2. Llojet e veprimtarive të mësimore në auditor janë si më poshtë:
  - a) Leksion;
  - b) Seminar/Ushtrim;
  - c) Laborator;
  - ç) Praktikë profesionale/ klinike/ kërkimore-shkencore.
3. Frekuentimi i procesit mësimor përcaktohet në rregulloren e programit të studimit.  
Frekuentimi i leksioneve është si rregull fakultativ, por institucionet e arsimit e lartë mund të përcaktojnë, në aktet e tyre të brendshme rregullatore, frekuentim për lëndë/grup lëndësh të veçanta.  
Për llojet e tjera të veprimtarive në auditor frekuentimi është si më poshtë:
  - a) Për programet e studimit me karakter profesional, programet e studimit të ciklit të parë, programet e studimit të ciklit të dytë, “Master Profesional”, programet e studimit të ciklit të dytë, “Master i shkencave”/ “Master i Arteve” dhe programet e studimit të ciklit të tretë “Master Ekzekutiv”, veprimtaritë e tjera mësimore në auditor janë si më poshtë:
    - i. Seminare/Ushtrime 75 %;
    - ii. Laboratorë 75 %;
    - iii. Praktika profesionale/klinike 75 %.
  - b) Për programet e studimit të ciklit të tretë “Specializim afatgjata të ciklit të tretë” dhe programet e studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” që përmbajë si pjesë të tij, lëndë të formimit teorik, veprimtaritë mësimore të tjera në auditor janë si më poshtë:

- i. Seminare/Ushtime 50 %;
- ii. Laboratorë 75 %;
- iii. Aktivitete profesionale/klinike/kërkimore-shkencore 75 %.

- 4. Institucionet e arsimit të lartë në aktet e tyre rregullatore dhe për fusha specifike të programeve të studimit mund të rritin masën e frekuentimit të procesit mësimor, të përcaktuar në këtë udhëzim.
- 5. Në rastet kur një IAL lëshon diplomë të përbashkët ose të dyfishtë me një IAL të huaj, frekuentimi i procesit mësimor bëhet sipas parashikimeve të këtij udhëzimi ose të marrëveshjes midis palëve.
- 6. Udhëzimi nr. 13, datë 20.06.2022 “Për frekuentimin e procesit mësimor, sipas llojit të veprimtarive mësimore në auditor dhe ciklit të studimit”, shfuqizohet.
- 7. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI**

**EVIS KUSHI**

